

KODI ETIK

URDHRI I FARMACISTËVE TË SHQIPËRISË

Misioni Ynë

Urdhri i Farmacistëve ka për mision ruajtjen dhe garantimin e nivelit të lartë të formimit dhe të edukimit shkencor e profesional të farmacistëve, ushtrimin e profesionit sipas kërkesave shkencore, të normave të etikës mjekësore e të Kodit të Deontologjisë Farmaceutike Shqiptare dhe mbrojtjen e pacientëve e të konsumatorëve nga kequshtrimet profesionale dhe shkeljet e normave të detyrueshme.

Kodi i Etikës i UFSH-së, është deklarata gjithëpërfshirëse e vlerave, sjelljeve dhe parimeve të cilat duhet ndiqen dhe të udhëheqin veprimtarinë e punonjësve të UFSH-së.

Parimet që na udhëheqin

Të gjithë punonjësit e UFSH-s kanë përgjegjësinë ndaj shtetit dhe popullit Shqiptar për të qënë besnik ndaj Kushtetutës, ligjeve dhe parimeve të etikës, për tu sjellë sipas standarteve më të larta të ndershmërisë, integritetit dhe paanshmërisë, për ta mbajtur sa më të lartë efektivitetin e punës dhe figurën e strukturave të Urdhrit, si edhe për të rritur e forcuar besimin dhe mbështjen e publikut ndaj tyre.

Të veprojnë me paanësi dhe të mos trajtojnë në mënyrë favorizuese asnjë subjekt/individ.

Të mos kryejnë, as të marrin pjesë në punë zyrtare të cilat, sipas njohurive të tyre mund të kenë një efekt direkt në interesat private të tyre.

Vlerat tona bazë

- Ndershmëri, integritet, besueshmëri, profesionalizëm
- Pavarësia, objektiviteti, paanshmëria.

- Ruajtja e sekretit profesional.
- Punë e përbashkët në grup, e bazuar në sinqeritet dhe në besim reciprok.
- Inkurajimi i marrjes përsipër dhe i përballimit të sfidave e përgjegjësive.
- Vlerësimi i gjyqimeve të publikut për veprimtarinë e Urdhrit.

Qëllimi

Ky Kod ka si qëllim që të shërbejë si udhëzues për të gjithë punonjësit e UFSH-së lidhur me veprimet e përditshme apo me ato vendimmarrse në përputhje me Misionin, Parimet që na udhëheqin dhe vlerat tona bazë. Qëllimet e Urdhrit kërkojnë që gjithkush që punon për këtë institucion, të respektojë apo të zbatojë standarde më të larta të etikës, ku përbushja e detyrimeve ndaj publikut duhet të prevalojë mbi interesat e çdo punonjësi të UFSH-së.

Të gjithë punonjësit kanë përgjegjësi për të kontribuar në qeverisjen e mirë të institucionit dhe të ndihmojnë në mbajtjen lartë të emrit të mirë të tij për ndershmëri, korrektesë, drejtësi, integritet dhe paanshmëri, përgjegjshmëri dhe profesionalizëm.

Moszbatimi i rregullave të kërkuara në këtë Kod dhe i rregullave apo i rregulloreve të Urdhrit të Farmacistëve të lidhura me të, përbën arsye për veprime disiplinore nga UFSH. Kur shkeljet konsiderohen serioze mund të shkaktojnë edhe përfundimin e marrëdhënieve me Urdhrin. Gjithkush ka të drejtë që të paraqesë këndvështrimin e tij lidhur me shkakun e përfundimit të marrëdhënieve dhe, në rastin e mosqënies dakord, ka të drejtë të apelojë vendimin përkatës.

Ky Kod zbatohet nga të gjithë punonjësit e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë.

Parimet bazë të sjelljes

Punonjësit e Urdhrit duhet të ndjekin dhe të respektojnë standardet më të larta të të vepruarit etik. Ata duhet të veprojnë me profesionalizëm dhe të vënë në dispozicion të Urdhrit të Farmacistve të gjitha njohuritë e tyre, në mënyrë të

ndershme, të pavaruar, të paanshme, pa marrë parasysh interesat personale dhe duke shmangur çdo situatë të prirur për të shkaktuar një konflikt interesash.

Punonjsit e Urdhrit duhet të trajtojnë me mirësjellje dhe me respekt kolegët e tyre. Ata duhet që nëpërmjet sjelljes së tyre të motivojnë punën dhe përkushtimin e stafit për kryerjen sa më mirë të detyrave të ngarkuara.

Ligjshmëria

Punonjësit e Urdhrit, duhet të zbatojnë me korrektësi dhe duhet të përmbushin të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, që rregullojnë veprimtarinë e Urdhrit, duke përfshirë dhe rregulloren e brendshme të insitucionit.

Punonjësit e Urdhrit veçanërisht kujdesen, që vendimet, të cilat prekin të drejtat apo interesat e individëve, të kenë bazë ligjore dhe përmbajtja e tyre të jetë në respekt të ligjit.

Mosdiskriminimi

Punonjësit duhen të shmangin çdo diskriminim të pajustificuar midis subjekteve ankuese/kërkuese bazuar në kombësi, gjini, racë, etnicitet apo origjinën shoqërore, veçoritë genetike, gjuhën, fenë apo besimin, mendimin politik apo tjetër, anëtarësimin në një minoritet kombëtar, pronësinë, lindjen, paaftësinë fizike, moshën apo orientimin seksual.

Mosabuzimi me pushtetin

Punonjësit e Urdhrit duhet të ushtrojnë pushtetin vetëm për qëllimet, të cilat janë të caktuara në dispozitat përkatëse. Ata duhet të shmangin përdorimin e këtyre pushteteve për qëllime, të cilat nuk kanë bazë ligjore, apo nuk janë të motivuara nga ndonjë interes publik.

Pavarësia

Punonjësit e Urdhrit duhet të jenë të drejtë, të arsyeshëm dhe të pavarur. Ata duhet të shmangin çdo veprim apo mosveprim arbitrar apo çdo trajtim preferencial, që prek negativisht publikun, i cili mund të jetë në dëm të interesave të personit, organit të administratës publike, organizatave, apo që cënon të drejtat dhe interesat e ligjshme të personave të tretë. Punonjësi gjithashtu, duhet të jenë objektiv në trajtimin e çështjeve dhe problemeve në shqyrtim.

Punonjësit e Urdhrit kur ushtrojnë detyrën e tyre nuk duhet të kërkojnë ose të marrin udhëzime nga institucione apo organizma të tjerë jashtë Urdhrit. Ata, gjithashtu, nuk duhet të ndikohen nga çdo subjekt tjetër që kërkon të influencojë tek ata për të ndërhyrë në veprimtarinë e Urdhrit.

Punonjësit duhet të zbatojnë, pavarësisht nga pikëpamjet e tyre personale, në kohë dhe me përpikmëri, urdhërat e dhëna nga eprori. Ata mbajnë përgjegjësi për ligjshmërinë e veprimeve që kryejnë e për këtë arsye, kur nuk janë të bindur për ligjshmërinë e urdhërave e të vendimeve që zbatojnë, duhet të informojnë menjëherë organet apo nivelet urdhërdhënëse, si dhe organet eprorë.

Integriteti

Punonjësit e Urdhrit duhet të veprojnë me integritet gjatë gjithë veprimtarisë së tyre zyrtare si dhe të shmangin çfarëdo shjelljeje që mund të paraqesë ndryshe Urdhrin e Farmacistve. Me integritet do të kuptohet ndershmëri, korrektesë, drejtësi dhe besnikëri kundrejt punës dhe institucionit.

Paanshmëria

Stafi i Urdhrit duhet të veprojë me paanshmëri. Punonjësit duhet të tregojnë kujdes që shprehja e pikëpamjeve dhe e bindjeve personale, të mos kompromentojë rezultat e detyrave të ngarkuara apo interesat e Urdhrit.

Sjellja e tyre zyrtare duhet të karakterizohet gjithnjë nga objektiviteti dhe profesionalizmi. Ata nuk duhen të lejojnë që marrëdhëniet apo konsideratat

personale, përfshirë këtu edhe paragjykimet, njëanshmëritë apo favorizimet, të ndikojnë në rezultatet e detyrës zyrtare.

Maturia

Punonjësit e Urdhrit duhet të tregojn maturinë më të madhe gjatë veprimeve të tyre, të kenë takt dhe të jenë të rezervuar në deklaratimet që bëjnë në përputhje me statusin e tyre në Urdhër. Punonjësit duhet të shmangin pjesëmarrjen në çdo aktivitet që është në kundërshtim me interesat e Urdhrit apo që mund të dëmtojë reputacionin e tij.

Paraqitja në punë, mirësjellja dhe respekti

Paraqitja në punë duhet të jetë e përshtatshme dhe e tillë që të shprehë kujdesin dhe seriozitetin e vazhdueshëm të punonjësve të institucionit për anën e tyre pamore, nivelin e domosdoshëm të pastërtisë personale, si dhe vëmendje në mënyrën e komunikimit dhe të qëndrimit në ambientet e Urdhrit.

Punonjësit e Urdhrit duhen të plotësojnë kërkesat e domosdoshme të veshjeve serioze në ambientet e zyrës. Për meshkujt veshja duhet të jetë me pantallona serioze e këmishë. Për femrat, me veshje të përshtatshme serioze, joekstravagante, me funde jo shumë të shkurtra apo këmisha e bluza dekolte.

Punonjësit e UFSH-së duhet t'i trajtojnë kolegët e tyre (qofshin këta eprorë, apo vartës) me mirësjellje dhe respekt, dhe nuk mund kenë tendenca të ngacmimeve fizike apo me fjalë. Stafi i Urdhrit duhet që gjithnjë të shmangi edhe ato sjellje, që megjithëse nuk arrijnë në nivelin e ngacmimit apo abuzimit, mund të krijojnë një atmosferë jo miqësore apo fizike. Konsiderohen si ngacmime dhe do të trajtohen si të tilla të gjitha ato fjalë apo sjellje, që ndërhyjnë në mënyrë të paarsyeshme në punën e gjithkujt, apo që krijojnë një mjedis pune frikësues (kërcënues), armiqësor dhe fytes, brenda institucionit, atje ku punonjësit ushtrojnë detyrën e tyre.

Do të konsiderohen si ngacmime seksuale dhe do të trajtohen si të tilla të gjitha përpjekjet e padëshiruara seksuale, kërkesat për favore seksuale, ose të tjera sjellje fizike ose verbale me natyrë seksuale të cilat ndikojnë në kryerjen e punës, kushtëzojnë punësimin apo krijojnë një mjedis pune fyes, jomiqësor apo frikësues brenda UFSH-së

Marrdhënia me të tretët

Punonjësit duhet të sillen sa më mirë dhe sa më njerëzishëm me publikun, duke u shërbyer atij me efikasitet, shpejtësi, kulturë dhe cilësi. T'i japin publikut informacionet e nevojshme, me përjashtim të informacioneve, që në bazë të dispozitave përkatëse konsiderohen sekrete, ose për përdorim të brendshëm. *Çështjet me karakter konfidencial, sekrete ose për përdorim të brendshëm, trajtohen sipas rregullave të nxjera nga Këshilli i Ministrave.*

Punonjësit e institucionit duhet të jenë mendje hapur, korrekt, të sjellshëm dhe të aksesueshëm në raport me publikun. Kur i përgjigjen korrespondencës, thirrjeve telefonike dhe postës elektronike, punonjësit duhet të përpiqen të jenë sa më ndihmues dhe të japin përgjigje pyetjeve që i janë bërë në mënyrë sa më të plotë e të saktë që të mundet. Nëse punonjësi nuk është përgjegjës për çështjet në fjalë, ai duhet të drejtojë individin/subjektin në zyrën përkatëse.

Diversiteti

Si pasojë e karakterit demokratik që ka Urdhri dhe e vlerës që ky i fundit i jep diversitetit, duhet që punonjësit të veprojnë me tolerancë, me ndjeshmëri, me respekt dhe me paanësi kundrejt kulturës dhe formimit të personave të tjerë, që nuk i kanë ato të njëjta me ta. Nga ana tjetër, Urdhri reagon ndaj çdo sjelljeje abuzive, e cila do të konsiderohet fyese për ambientin apo për persona konkretë.

Përdorimi i pronave, pajisjeve dhe burimeve në Urdhër

Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Urdhër, punonjësit duhet të mbrojnë dhe të ruajnë pronën e institucionit. Nuk lejohet që punonjësit, drejtpërsëdrejti ose

jodrejt përsëdrejti, të përdorin apo të lejojnë që të përdorin pronën e Urdhrit për qëllime të tjera, përveçse për kryerjen e punës.

Me pronë të Urdhrit kuptohet çdo pasuri e luajtshme dhe e paluajtshme që ka në përdorim, në gëzim dhe disponim Urdhri, si dhe dokumentacioni zyrtar.

Punonjësit e Urdhrit, në rastet kur përdorin komunikimin e brendshëm elektronik në institucion, duhet të kujdesen që ai të përdoret vetëm për çështje që kanë lidhje me punën dhe jo për interesa private.

Hakmarrja

Dëmtimi që pësohet si rezultat i akuzave të pabazuara dhe joserioze dekurajon punonjësit lidhur me sjelljen dhe me zbatimin e standardeve të larta etike. Si pasojë, Urdhri mbron punonjësit e tij në rastet kur ata bëhen objekt i akuzave të pabaza nga çdokush që mbetet i pakënaqur si pasojë e kryerjes së rregullt të detyrës prej tyre.

Liria dhe përgjegjësia për të ngritur probleme, çështje apo shqetësime është thelbësore për të fuqizuar punonjësit dhe për të ruajtur integritetin si institucion. Si pasojë, Urdhri do të mbrojë punonjësit nga hakmarrjet e çdo lloji, përfshirë edhe ato të ardhura si pasojë e qëndrimeve të mbajtura në rastin e ngritjes së problemeve dhe të shqetësimeve të ndryshme. Kjo përgjegjësi për të mbrojtur punonjësit zbatohet lidhur me persona, të cilët cënojnë ose aplikojnë hakmarrjen kundër punonjësve të tij gjatë zbatimit të detyrave. Ankesat për hakmarrje trajtohen seriozisht dhe sqarohen menjëherë.

Marrëdhëniet me median, deklaratimet publike dhe publikimet

Brenda Urdhrit saktësohen procedura të veçanta lidhur me mundësinë e kontakteve me mediat. Kontakti me median (shtypin e shkruar dhe atë elektronik) lidhur me veprimtarin e Urdhrit do të mbahen vetëm nga personi i autorizuar për komunikim me median, i cili këshillohet dhe informon titullarin e institucionit. Në rastet kur media kontakton drejtëpërdrejt një nga punonjësit

e Urdhrit, ky i fundit duhet të këshillohet me personin e autorizuar për komunikimin me median.

Punonjësi, nëse nuk është i autorizuar, nuk duhet që të japë, të publikojë apo të nxjerrë për përdorim publik materiale, që kanë të bëjnë me veprimtarin e Urdhrit.

Konfidencialiteti

Punonjësi i institucionit ruan konfidencialitetin e informacionit që ka në zotërim gjatë ushtrimit të detyrës së tij, apo gjatë aktivitetit në institucion, takim pune, etj, por pa cënuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji Nr., datë “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Konflikti i interesave

Punonjësit e Urdhrit duhet të evitojnë çdo situatë që përbën shkak për lindjen e një konflikti interesash. Me konflikt interesi kuptohet konflikti ndërmjet interesit privat dhe interesit publik gjatë marrëdhënieve juridike të punës në UFSH.

Konflikti i interesit është situata në të cilën punonjësi i UFSH-së ka një interes personal të tillë që ndikon ose mund të ndikojë në paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së detyrës zyrtare. *Rastet e konfliktit të interesave janë të përcaktuara në Ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.*

Punonjësi duhet të veprojë gjithnjë në interes të institucionit dhe veprimtaria e çdo punonjësi duhet të jetë në përputhje me ligjet, rregullat dhe misionin e UFSH-së.

Punonjësi i institucionit, kur i ngarkohet një çështje e cila e vendos në konflikt, duhet të deklarojë, në rastin më të parë të mundshëm, konfliktin ose konfliktet e mundshme të interesave, të cilat mund të ndikojnë negativisht në ushtrimin dhe përmbushjen e detyrave të tij me korrektësi.

Gjatë punësimit në Urdher, punonjësit mund t'i lindin apo të përfitojë të drejta pasurore ose interesa, që mund t'a pengojnë apo që mund të bëhen shkak për lindjen e konflikteve, në zbatimin e detyrës së tij. Në rast se këto interesa klasifikohen si të tillë dhe punonjësit i kërkohet që të heqë dorë prej tyre, ai duhet t'i bindet kësaj kërkesë.

Konfliktet e mundshme të interesit të një kandidati për t'u punësuar në administratën e Urdhrit, duhet të zgjidhen mundësisht përpara emërimit të tij.

Punonjësit e UFSH-së zbatojnë kërkesat e parashikuara Ligjin nr. 9637 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar dhe kërkesat e Ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike"

Dhuratat, shpërblimet për punonjësit

Gjatë punësimit në UFSH, punonjësve nuk i lejohet që të kërkojnë ose të pranojnë drejtpërsëdrejti ose jodrejtpërsëdrejti, dhurata, shpërblime, favore, argëtime, kredi, hua ose çdo gjë tjetër, që ka vlerë monetare, nga persona ose subjektë që: -kanë ose që kërkojnë të sigurojnë përfitime në procedurat administrative, në marrëdhëniet kontraktore ose në çdo marrëdhënie tjetër me UFSH; -kanë interesa që preken në mënyrë thelbësore nga kryerja ose nga moskryerja e detyrave zyrtare të punonjësve të UFSH-së.

Komunikimi

Në komunikimin e përditshëm brenda institucionit, punonjësit e Urdhrit duhet të respektojnë shkallën hierarkike. Gjatë komunikimit, çdo punonjës duhet të karakterizohet nga etika dhe respekti i ndërsjelltë. Komunikimi verbal në ambientet e Urdhrit nuk duhet të bëhet me zë të lartë.

Zbatimi i orarit të punës

Punonjësit duhet që, gjatë marrëdhënieve të punësimit në Urdhër, të përdorin në mënyrë efektive kohën e punës, vetëm në interes të institucionit. Koha e

punës nuk duhet përdorur për asnjë qëllim tjetër, përveçse në rastet kur përdorimi i saj për qëllime të tjera është i autorizuar në përputhje me ligjet dhe me rregullat në fuqi.

Çdo mungesë në detyrë duhet të bëhet me leje. Këtu bëjnë përjashtim rastet për arsye shëndetësore. Në raste të veçanta nëpunësi duhet të njoftojë eprorin për çdo largim nga vendi i punës.

Pijet alkolike dhe pirja e duhanit

Ndalohet rreptësisht përdorimi i pijeve alkolike nga të gjithë punonjësit e institucionit si brënda, ashtu edhe jashtë tij, gjatë kohëzgjatjes normale të punës.

Në të gjitha ambjentet e institucionit është e ndaluar pirja e duhanit. Ajo mund të lejohet vetëm në vëndet e caktuara për këtë qëllim.

Sanksione

Për punonjësit e Urdhrit që shkelin rregullat e parashikuara të këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, do të zbatohen masat disiplinore, që janë:

- Vërejtje;
- Paralajmërim për largim nga puna;
- Largim nga puna.

Ngarkohet eprori direkt i punonjësit të kontrollojë nëse ai zbaton rregullat e sipërpërmendura të etikës dhe të propozojë masat e duhura disiplinore në rastet e shkeljes së këtyre rregullave.

Ngarkohen punonjësit e Administratës Qëndrore të UFSH-së për zbatimin e këtij Kodi.

Ky Kod hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar me Vendimin Nr. 10, datë 17.03.2017 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë.